

nëntor 2023

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin tetor

2023

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin tetor

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, nëntor 2023

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

Kontrulli dhe vlerësimi i deklaratave

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07. 08.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues, i pari i këtij lloji në Kosovë, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit tetor 2023, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Formati i këtij raporti është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i gjashtëmbëdhjetë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është ideuar nga platforma për kontroll të fakteve hibrid.info, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në kuadër të raportit jepet një pasqyrë për formën e informimit mediatik me ngjarjet për dhe rreth Kosovës. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info, e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.


Kategoritë monitoruese janë:

- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

KATEGORITË KRYESORE
Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Të dhënat e muajit tetor 2023 (99 përmbajtje keqinformuese) për gjendjen e çrregullimit informativ në Kosovë tregojnë për ndryshime për sa i përket trendëve të përmbajtjeve keqinformuese të publikuara nga media dhe publikues të ndryshëm.

Përderisa gjatë muajve të fundit shumica e artikujve keqinformues ishin kryesisht clickbait dhe dezinformata, në disa raste, gjatë këtij muaji, përmbajtjet e paverifikuara janë në vendin e parë me 29%, duke dominuar të gjitha kategoritë e tjera. Përmbajtjet e paverifikuara pasohen nga dezinformatat me 21%, lajmi i rremë me 18%, dhe “clickbait” tek në vendin e katërt me 17%. Edhe pse kategoria “clickbait” është radhitur si e para muajt paraprak, gjatë tetorit ajo pëson një rënie të konsiderueshme.

Ndërkohë, gjetje tjetër me rëndësi janë keqinformimet e vlerësuara si përmbajtje e paverifikuar të cilat, gjatë muajit të kaluar (shtator), shënuan ngritje prej 25%, duke u radhitur e dyta. Ndërsa në këtë muaj (tetor) është radhitur e para me një rritje prej 29%, duke rezultuar me rritjen më të madhe në raport me muajt korrik e gusht 2023 që paraqitej në përqindje pothuajse të papërfillshme (6% në muajin korrik 2023 dhe 3% në muajin gusht 2023).

Ndër arsyet kryesore të këtyre ndryshimeve në kategoritë e keqinformimit janë rritja e numrit të përmbajtjeve keqinformuese në fushën e sigurisë, si në muajin shtator, po ashtu edhe në këtë muaj, të cilat kanë rritur përqindjen e vlerësimeve – përmbajtje e paverifikuar. Si rezultat i kësaj, përmbajtjet e paverifikuara kanë mbizotëruar si shkak i përqindjes së keqinformative nga fusha e sigurisë në ndërlidhje me konfliktin Izrael-Hamas, të cilat kanë marrë vlerësime si përmbajtje e paverifikuar.

Si rrjedhojë, kjo ka ndikuar në përqindje më të ulët të artikujve clickbait për shkak të numrit dukshëm më të vogël të publikimeve keqinformuese në fushën sociale dhe kronikën e zezë gjatë muajit tetor 2023 që zakonisht marrin vlerësime clickbait.



29% e artikujve keqinformues kanë marrë vlerësimin “përmbajtje e paverifikuar”.

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1.1

01. Përmbajtje e paverifikuar

Keqinformata të cilat janë vlerësuar në këtë kategori janë publikuar kryesisht nga faqe dhe llogari në gjuhën shqipe që operojnë në mediat sociale, konkretisht në Facebook. Pjesa dërrmuese e keqinformatave të vlerësuara si përmbajtje e paverifikuar janë krijuar dhe shpërndarë në fushën e sigurisë, ndërlidhur me konfliktin Izrael-Hamas. Në kuadër të kësaj janë publikuar imazhe dhe video-materiale nga publikues në mediat sociale me pretendimin se paraqesin gjendjen e konfliktit Izrael-Hamas, e që janë cilësuar përmbajtje e paverifikuar për faktin se nuk përbënin pamje nga konflikti.

03. Lajm i rremë

Të gjitha lajmet e rreme, sipas mostrës së monitorimit e kontrollit të fakteve, janë publikuar nga faqe dhe llogari në gjuhën shqipe në mediat sociale. Pothuajse të gjitha lajmet e rreme janë publikuar në fushën e sigurisë dhe politikës. Ndërsa lajmet e rreme nga fusha e sigurisë kishin të bënin me imazhe dhe video materiale të rreme për konfliktin Izrael-Hamas, si dhe pretendime të rreme për armatosjen e FSK-së me armë të ndryshme.

05. Përmbajtje e paverifikuar/Dezinformatë

Të gjitha keqinformatat të cilat janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar/dezinformatë janë publikuar nga publikues në mediat sociale, në gjuhën shqipe. Ato janë publikuar në fushën e sigurisë dhe kanë përmbajtur imazhe të gjeneruara me inteligjencë artificiale (IA) dhe video-materiale rreth konfliktit Izrael-Hamas.

02. Dezinformatë

Një numër i konsiderueshëm i dezinformatave janë publikuar nga publikues që krijojnë dhe shpërndajnë përmbajtje në gjuhën shqipe në mediat sociale. Pjesa më e madhe e tyre janë publikuar nga fusha e sigurisë, kurse pjesa tjetër janë nga politika, socialja dhe sporti. Dezinformatat nga fusha e sigurisë dhe politikës në gjuhën shqipe të publikuara në mediat sociale përfshinin imazhe dhe video-materiale të rreme nga konflikti Izrael-Hamas, ndërkaq në gjuhën serbe në media u publikuan dezinformata me pretendimin e rremë se Hamasi ka blerë armë nga UÇK-ja.

04. Clickbait

Pothuajse të gjitha përmbajtjet e vlerësuara si “clickbait” janë publikuar nga media reale (portale informative) në gjuhën shqipe. Një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve “clickbait” janë krijuar e publikuar në fushën e kronikës së zezë dhe atë të sociale. Përderisa artikujt “clickbait” nga kronika e zezë ndërlidheshin me raste tragjike (vdekje, vrasje) për të cilat nuk bëhej e ditur vendndodhja e ngjarjes në titull, ato nga fusha sociale kishin të bënin me keqinformime për produkte ushqimore dhe për mundësi për punë në Zvicër.

06. Mashtrim


Përmbajtjet mashtruese janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale në gjuhën shqipe. Të gjitha këto përmbajtje mashtruese janë nga fusha sociale dhe politike. Përmbajtjet mashtruese nga fusha sociale lidhen me pretendime mashtruese për dhënie kredish dhe deepfake video të Elon Musk duke folur në gjuhën shqipe. Ndërsa ato nga fusha politike, ndërlidhen me deepfake video të Albin Kurtit duke folur arabisht dhe montimin e imazhit të Adem Jasharit në një pikturë në ditën hapëse të Samitit të Berlinit në Tiranë.

Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: “Mashtrim”, “Teori konspirative”, “Gabim” dhe nga kombinim i kategorive “Dezinformatë/Clickbait” e “Dezinformatë/Përmbajtje e paverifikuar”

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

2

KATEGORITË KRYESORE
Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Bazuar në monitorimin e përmbajtjeve keqinformuese për muajin tetor, publikuesit e ndryshëm kanë publikuar përmbajtje keqinformuese për konfliktin Izrael-Hamas me 49%. Si pasojë e zhvillimeve në atë pjesë që nisen më 7 tetor, në mediat sociale u publikuan shumë përmbajtje të paverifikuara me pretendimin se paraqesin informacione rreth konfliktit. Rritja e publikimeve keqinformuese lidhur me këtë temë vjen si rezultat i dinamikës së zhvillimeve lidhur me këto ngjarje dhe ndikimin që kishte në audiencë.

Edhe gjatë muajit tetor, përmbajtjet nga kronika e zezë, të cilat vlerësohen si “clickbait” dhe që trajtojnë tema tragjike, si vrasje, vdekje, aksidente me fatalitet, radhiten si të dytat me 6%. Artikuj me tematikë të tillë kanë pësuar rënie në përqindje për dallim nga muaji i kaluar (shtator 16%), megjithatë, mbetet si kategoria kryesore gjatë muajve të fundit (korrik, gusht dhe shtator, 2023). Siç duket, ky lloj i keqinformimit bëhet për nxitje të klikimeve në poste/artikujve të kronikës së zezë nën aludimin se ngjarja mund të ketë ndodhur në hapësira shqipfolëse (Kosovë, Shqipëri apo gjetiu).

Gjatë muajit tetor, po ashtu u publikuan përmbajtje keqinformuese rreth armatosjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së). Këto përmbajtje keqinformuese bazoheshin në lajmet e sakta të blerjes së dronëve “Bayraktar” nga Turqia, por duke ngritur edhe pretendime të tjera të rreme. Kjo temë kishte dominuar gjatë muajit qershor kur ishte bërë e ditur blerja e dronëve, kurse spekulimet për blerje të armëve të tjera qarkullojnë herëpashere kryesisht në mediat sociale.

Për dallim nga muaji paraprak (shtator), kur përmbajtjet keqinformuese nga veriu kishin mbizotëruar për shkak të sulmit terrorist në Banjaskë, gjatë tetorit zhvillimet në veri kanë qenë të qeta, prandaj kjo temë radhitet si e katërta, me vetëm 4%.

Në kuadër të këtij muaji, janë publikuar përmbajtje keqinformuese ndërlidhur me pretendime të rreme për vende pune në Zvicër, si dhe për deklaratat e pathëna të Edi Ramës ndërlidhur me Albin Kurtin dhe Ramush Haradinajn.



68% e temave kryesore që u përdorën për keqinformim lidhen me konfliktin Izrael-Hamas, raste tragjike në rrethana të ndryshme, armatosjen e FSK-së, veriun, punë në Zvicër dhe deklaratat e Edi Ramës.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

2.1

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Konflikti Izrael-Hamas

Pothuajse të gjitha përmbajtjet keqinformuese ndërlidhur me këtë temë janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale në gjuhën shqipe. Pjesa dërrmuese e këtyre përmbajtjeve janë publikuar në fushën e sigurisë, ndërsa një pjesë e vogël nga fusha e politikës. Përmbajtjet keqinformuese lidhur me këtë janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar dhe dezinformata. Nga llogari dhe faqe në mediat sociale, në gjuhën shqipe, me pretendimin të paraqesin situata nga konflikti, janë publikuar imazhe dhe video-materiale të vjetra, kryesisht nga lufta e Sirisë, tërmeti në Turqi, protesta të vjetra, si dhe të konflikteve paraprake në mes të Izraelit dhe Palestinës. Në kuadër të kësaj, nga këto faqe dhe llogari janë publikuar edhe imazhe të gjeneruara më inteligjencë artificiale, e që mund të thuhet se për herë të parë përdoret inteligjenca artificiale për të gjeneruar imazhe rreth një konflikti ndërkombëtar. Ndërsa, në mediat në gjuhën serbe është publikuar dezinformata se Hamasi ka blerë armë nga UÇK-ja.

03. Armatosja e FSK-së

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese rreth furnizimit më armë të FSK-së janë publikuar nga faqe dhe llogari të ndryshme në mediat sociale në gjuhën shqipe. Këto përmbajtje janë në fushën e sigurisë me pretendimet se FSK-ja është furnizuar me tanke, helikopterë dhe aeroplanë, pretendime këto të vlerësuara si “lajm i rremë”.

02. Raste tragjike

Përmbajtjet keqinformuese lidhur me raste tragjike të ndryshme që ndërlidhen me vrasje, vdekje, aksidente me fatalitet, terrorizëm, janë publikuar nga media reale (portale informative) në gjuhën shqipe. Të gjitha këto përmbajtje janë publikuar nga fusha e kronikës së zezë dhe janë vlerësuar si “clickbait”.


04. Veriu

Për këtë temë kanë vazhduar të publikohen përmbajtje keqinformuese në mediat sociale në gjuhën shqipe ndërlidhur me sulmin në Banjskë. Të gjitha këto përmbajtje keqinformuese të publikuara nga faqe dhe llogari në mediat sociale janë në fushën e sigurisë dhe janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar dhe dezinformata.

3

Llojet e fushave

Bazuar në matjet e bëra për muajin tetor, publikues të ndryshëm (media reale, portale të dyshimta dhe publikuesit në mediat sociale) kanë krijuar dhe shpërndarë më së shumti keqinformata në fushën e sigurisë. Përdërisa në muajin shtator fusha e sigurisë kishte mbizotëruar si rezultat i keqinformatave për sulmin terrorist në Banjaskë, këtë muaj (tetor) vazhdon të renditet e para për shkak të publikimit të përmbajtjeve keqinformuese për konfliktin Izrael – Hamas. Krahas kësaj, në fushën e sigurisë kanë vazhduar të publikohen keqinformata rreth sulmit terrorist në Banjaskë edhe gjatë tetorit, si dhe përmbajtje keqinformuese për furnizimin me armatim të FSK-së.




Edhe pse në muajin shtator 2023, fusha e sigurisë ishte radhitur si e para me 33%, si hera e parë që nga muaji dhjetor 2022, ajo ka vazhduar të mbizotërojë edhe në muajin tetor 2023, por me një rritje të konsiderueshme prej 19% (52% në tetor). Konflikti Izrael-Hamas, i nisur me 7 tetor, ka ndikuar që keqinformimet në fushën e sigurisë të jenë në mbi 50%. Fusha e sigurisë pasohet nga ajo e politikës (21%), e cila paraqitet me një rritje të lehtë krahasuar me muajin shtator. Pavarësisht këtyre të dhënave monitoruese, nëse këto dy fusha llogariten së bashku, atëherë mund të thuhet se 73% e të gjithë artikujve keqinformues të publikuar në muajin tetor 2023 janë mbizotëruar nga tematikat politike dhe të sigurisë, e cila dëshmon për dominim në masë të madhe të tyre.

Sa i përket artikujve keqinformues në fushën sociale, të dhënat tregojnë se nuk ka ndryshim prej muajit paraprak (shtator) sa i përket përqindjes. Por, ka ndryshim në radhitje. Përdërisa fusha sociale me 9% radhitej si e gjashta në muajin shtator, në muajin tetor, me po të njëjtën përqindje, radhitet si e treta. Karakteristikë tjetër e këtij muaji është rënia e dukshme, prej 18% e publikimeve keqinformuese, në kronikë të zezë, (nga 27% si e dyta në muajin shtator 2023, tani në 9% si e katërta në muajin tetor 2023).

Pothuajse të gjitha përmbajtjet keqinformuese në fushën e sigurisë janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale (50%), ndërsa 2% e tyre janë publikuar në media reale. Në fushën e sigurisë, 24% e keqinformative janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar, 12% dezinformata, 10% lajm i rremë, 5% përmbajtje e paverifikuar/dezinformata dhe 1% “clickbait”. Pothuajse të gjitha përmbajtjet e paverifikuara dhe dezinformatat, si dhe një pjesë e konsiderueshme e lajmeve të rreme janë publikuar për konfliktin Izrael-Hamas. Pjesa dërrmuese e tyre janë publikuar nga publikues në gjuhën shqipe, ndërsa në mediat reale në gjuhën serbe u publikua dezinformata se Hamasi ka blerë armë nga UÇK-ja.

Sa i përket publikimeve keqinformuese nga fusha e politikës, 15% janë publikuar në llogari dhe faqe në mediat sociale, ndërsa 6% prej tyre janë publikuar në media. Keqinformatat nga kjo fushë janë kategorizuar si lajm i rremë (7%), dezinformata (5%), clickbait (4%), mashtrim (2%), teori konspirative (1%) dhe përmbajtje e paverifikuar (1%). Lajmet e rreme u publikuan nga publikues në mediat sociale për konfliktin Izrael-Hamas, si dhe për deklarata të pathëna të Edi Ramës ndërlidhur me Albin Kurtin dhe Ramush Haradinajn. Ndërkaq, dezinformatat janë publikuar në mediat sociale në gjuhën shqipe për konfliktin Izrael-Hamas. Përmbajtjet mashtruese të publikuara në mediat sociale përfshinin një video deepfake të kryeministrit Kurti duke folur në gjuhë arabe, dhe një imazh të montuar të Adem Jasharit në një pikturë në ditën hapëse të Samitit të Berlinit në Tiranë.

Përmbajtjet keqinformues nga fusha sociale më së shumti janë vlerësuar si “clickbait” (4%), pastaj mashtrim (2%), dezinformata/clickbait (1%), dezinformata (1%). Përmbajtjet “clickbait” janë publikuar në media reale dhe media sociale për çmimet e produkteve ushqimore dhe kërkesave për punë në Zvicër. Artikujt keqinformues nga fusha e kronikës së zezë janë vlerësuar si “clickbait” (7%) të publikuara në media reale dhe përmbajtje e paverifikuar (1%) të publikuar nga publikues në mediat sociale, për raste tragjike, tërmete dhe përmbajtje.



94% e përmbajtjeve keqinformuese janë për sigurinë, politikën, socialen, kronikën e zezë dhe sportin.

Llojet e publikuesve



4

Për dallim nga dy muajt paraprak (gusht-shtator), kur numri më i madh i artikujve keqinformues janë publikuar nga mediat reale, në muajin tetor ishin faqe e profile në mediat sociale, nga ku u keqinformua më së shumti. Keqinformatat kanë mbizotëruar në mediat sociale, madje ka rritje të konsiderueshme krahasuar me muajin paraprak (nga 39% në shtator 2023, në 73% në muajin tetor 2023). Kjo si rezultat i asaj se, shumica e përmbajtjeve të paverifikuara, dezinformatave dhe lajmeve të rreme, janë publikuar nga publikues në media sociale.

Të dhënat nga monitorimi tregojnë se 73% e përmbajtjeve keqinformuese janë shpërndarë nga faqe dhe llogari në mediat sociale, pasuar me 27% nga media reale. Krahasimi me muajin paraprak, shpërfaq se përmbajtjet keqinformuese të publikuara në mediat sociale kanë shënuar rritje prej 34%, ndërsa keqinformatat në media kanë pësuar rënie prej 32% (nga 59% në shtator 2023, në 27% në tetor 2023).

Gjatë monitorimit në muajin tetor, bazuar në mostrën e kërkimit të hibrid.info, nuk është hasur në keqinformata të publikuara nga portale të dyshimta.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




73% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga media sociale.

Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE TË NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Edhe gjatë këtij muaji, publikues të ndryshëm në gjuhën shqipe kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese me 96%. Kjo është e kuptueshme marrë parasysh se mostra e monitorimit nga platforma “hibrid.info” fokusohet më tepër tek përmbajtjet e publikuara në gjuhën shqipe nga mediat reale, publikuesit në mediat sociale dhe portalet e dyshimta, ndërsa në gjuhën serbe monitorohen kryesisht vetëm raportimet keqinformuese në mediat reale lidhur me zhvillimet për dhe rreth Kosovës.

Në bazë të të dhënave të monitorimit, 73% e përmbajtjeve në gjuhën shqipe janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale, ndërsa 23% në media reale. Ndërsa, të gjitha keqinformatat në gjuhën serbe janë publikuar në media reale (4%).

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët e tjera. Në vijim është përshkrimi i i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet në gjuhën shqipe

Publikues të ndryshëm në mediat sociale në gjuhën shqipe kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese për muajin tetor 2023, pasuar nga mediat reale. Përderisa në muajt paraprak kanë mbizotëruar përmbajtjet keqinformuese të kategorizuara si “clickbait”, në muajin tetor përmbajtjet e paverifikuara radhiten të parat me 29%, për shkak se një përqindje e konsiderueshme e keqinformatave nga fusha e sigurisë janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar. Kjo pasohet nga dezinformata me 20%, për të vazhduar më lajmin e rremë me 18% dhe “clickbait” me 17%. Pak më shumë se gjysma e keqinformatave në gjuhën shqipe janë krijuar dhe shpërndarë në fushën e sigurisë (51%), e cila pasohet nga politika (20%) dhe kronika e zezë (9%).

02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe (për dhe rreth Kosovës)


Të gjitha përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe janë publikuar nga mediat reale nga fusha e sigurisë, politika dhe sporti. Këto publikime keqinformuese në gjuhën serbe janë vlerësuar si teori konspirative, dezinformatë dhe dezinformatë/përmbajtje e paverifikuar. Në mediat në gjuhën serbe u publikua teoria konspirative me pretendimin se spiunë shqiptarë do të blejnë vota kundër presidentit Aleksandër Vuçiq në zgjedhjet në Serbi, dezinformata se Hamasi ka blerë armë nga UÇK-ja, dezinformatë/përmbajtje e paverifikuar për deklaratë të manipuluar të futbollistit Altin Zeqiri.

Llojet e mediave sociale

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Në bazë të monitorimit të bërë gjatë muajit tetor 2023 rezulton që kanë mbizotëruar përmbajtjet keqinformuese të publikuara në Facebook me 88%. Ashtu si në muajt paraprak, edhe në këtë muaj keqinformatat në Facebook kanë mbizotëruar krahasuar me TikTok, i cili radhitet i dyti me 12%, duke pësuar rënie krahasuar më muajt paraprak.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale, sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Në muajin tetor, faqe të ndryshme në gjuhën shqipe në Facebook kanë publikuar më së shumti përmbajtje të ndryshme keqinformuese, ndërsa pjesa tjetër është publikuar nga llogari me 8% dhe media me 8%. Edhe gjatë muajit tetor 2023, faqet në Facebook kanë mbizotëruar sa i përket shpërndarjes së artikujve keqinformues, duke u pasuar nga llogari në TikTok (12%).

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE



Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. Facebook

Më shumë se gjysma e keqinformatave të publikuara nga faqe, llogari dhe media në Facebook janë nga fusha e sigurisë (65%), pasuar nga politika (13%), sociale (7%), kronikë e zezë (2%) dhe shëndetësi (2%). Përmbajtjet e paverifikuara (35%), dezinformatat (23%) dhe lajmet e rreme (18%) janë kategoritë që kanë përbërë shumicën e keqinformatave të publikuar në Facebook. Sa i përket temave, keqinformatat për konfliktin Izrael-Hamas kanë mbizotëruar me 62%, pasuar nga armatosja e FSK-së me 7% dhe veriu me (5%).


02. TikTok

Shumica dërrmuese e publikimeve keqinformuese të llogarive në TikTok ndërlidhen me tema politike dhe të sigurisë, si dhe një keqinformim në fushën sociale. Këto përmbajtje të publikuara nga llogari në TikTok u vlerësuan si lajm i rremë dhe mashtrim. Lajmet e rreme ndërlidheshin me pretendime se “Serbia do të sulmojë Kosovën”, deklaratat e pathëna të Edi Ramës se “presidentin Vuçiq e ka më mirë se kryeministrin Kurti”, dhe se kryeministri belg ka thënë për Kurtin se “ai meriton të jetë lider i Evropës”. Në TikTok u publikuan përmbajtje mashtruese, video deepfake të kryeministrit Albin Kurti, duke folur arabisht dhe Elon Musk duke folur shqip, dhe pikturë të montuar me imazhin e Adem Jasharit në ditën hapëse të Samitit të Berlinit në Tiranë.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES




Në bazë të monitorimit për muajin tetor 2023, në përmbajtjet keqinformuese të publikuar për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë, institucionet e sigurisë ishin ato që u përfshinë dhe u përfolën në këto keqinformata. Në mesin e tyre, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është institucioni që më së shumti u përfol dhe u përfshi në keqinformatat e krijuara dhe të shpërndara nga publikues të ndryshëm. FSK-ja u përfol në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në mediat sociale (Facebook) me pretendimet se FSK-ja do të pajiset me tanke, dhe se Turqia i ka dhuruar FSK-së aeroplanë, helikopterë dhe 6 dronë “Bayraktar”.

Policia e Kosovës është institucioni i dytë më i përfolur në përmbajtjet keqinformuese në kontekst me institucionet tjera. Ky institucion i sigurisë u përfol në përmbajtjet keqinformuese lidhur me sulmin terrorist në Banjskë, përmbajtje këto që vazhduan të publikohen edhe gjatë muajit tetor në mediat sociale. Po ashtu, Policia e Kosovës u përfshi së bashku me Sindikatën e Policisë në publikime me përmbajtje të pasakta rreth pagesës së policëve të angazhuar në veri në periudhën e fundit.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) u përfol në përmbajtjen keqinformuese të publikuar në mediat në gjuhën serbe, me pretendimin dezinformues se grupi i armatosur i Hamasit ka blerë armë nga UÇK-ja.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Në bazë të të dhënave të monitorimit për muajin tetor 2023, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq dhe kryeministri, Edi Rama janë dy figurat më të përfolura në krahasim me personalitete tjera. Vuçiq u përfol në dy artikuj të vlerësuar si “clickbait” të mediave në gjuhën shqipe.

Si figurë e dytë më e përfolur në përmbajtjet keqinformuese gjatë këtij muaji zë vend kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Në TikTok u publikua një video “deepfake”, ku Kurti paraqitet duke folur arabisht, si dhe në përmbajtje në TikTok me pretendimin e rremë se gjoja kryeministri belg ka deklaruar se “Albin Kurti është i jashtëzakonshëm” dhe se “ai meriton të jetë lider i Evropës”.

Personalitete e figura tjera të përfolura janë Adem Jashari, ministrja Rozeta Hajdari, futbollisti Andi Zeqiri, Cristiano Ronaldo etj.

Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave

Hibrid.info, përveç kontrollit dhe analizës së artikujve mediatik, bën edhe kontrollin dhe vlerësimin e deklaratave të zyrtarëve të lartë politikë e institucionalë, si dhe figurave që kanë ndikim publik. Vlerësimi i këtyre figurave, sipas metodologjisë së hibrid.info, bëhet në kategoritë e vërtetësisë, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes së premtimeve.

RENDITJA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT TË DEKLARATAVE



Në kuadër të përmbajtjes së monitoruar gjatë muajit tetor, hibrid.info ka kontrolluar dhe analizuar dy deklarata që ndërlidhen me premtime politike.

Kryeministri Albin Kurti në vitin 2021, gjatë një vizite në ndërmarrjen publike “Trepça” në zgjedhjet lokale, kishte premtuar investime 70 milionë euro në dy vite (2022 dhe 2023) për këtë institucion. Në bazë të verifikimeve dhe kontrollit të fakteve, është vërtetuar se shumica e ndarë për ndërmarrjen në fjalë gjatë këtyre dy viteve arrin në 20 milionë euro, çka do të thotë se premtimi i kryeministrit Kurti nuk është mbajtur.

Në emisionin “Debat Plus” në televizionin Dukagjini, të datës 27 shtator ishte ngritur çështja e mos-ekzekutimit të shtesave të rrezikshmërisë për Policinë e Kosovës. Deputeti i Kuvendit të Kosovës, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Enver Dugolli, i ftuar në këtë emision, ishte shprehur se nuk ka marrëveshje nga Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme për mënyrën e trajtimit të këtij problemi dhe se kjo çështje do të zgjidhet për dy-tre ditë. Bazuar në faktin që problemi nuk ishte zgjidhur në kohën e paralajmëruar nga deputeti Dugolli, kjo deklaratë është vlerësuar si premtim jo i mbajtur.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në bazë të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 tetor 2023.

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit tetor 2023, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Në bazë të monitorimit të 99 përmbajtjeve keqinformuese për muajin tetor 2023, publikuesit e ndryshëm kanë krijuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje të paverifikuara me 29%, pasuar nga dezinformatat me 21%, lajmi i rremë më 18%, dhe “clickbait” tek në vendin e katërt me 17%. Pjesa dërmuese e keqinformatave të vlerësuara si përmbajtje e paverifikuar janë krijuar dhe shpërndarë në fushën e sigurisë, ndërlidhur me konfliktin Izrael-Hamas, dhe janë publikuar nga llogari dhe faqe në gjuhën shqipe në Facebook. Edhe një numër i konsiderueshëm i dezinformatave janë publikuar në mediat sociale nga fusha e sigurisë dhe politikës kryesisht për konfliktin Izrael-Hamas. Lajmet e rreme u publikuan në mediat sociale nga publikues në gjuhën shqipe, kryesisht imazhe dhe video materiale të rreme për konfliktin Izrael-Hamas, si dhe pretendime të rreme për armatosjen e FSK-së me armë të ndryshme. Ndërsa, pothuajse të gjitha përmbajtjet e vlerësuara si “clickbait” janë publikuar nga media reale (portale informative) në gjuhën shqipe, e që një pjesë e konsiderueshme e tyre janë krijuar e publikuar në fushën e kronikës së zezë dhe atë sociale.

Fokusi kryesor i publikuesve të ndryshëm gjatë muajit tetor 2023 është rreth temës së konfliktit Izrael-Hamas. Si pasojë e zhvillimeve konfliktuese ndërmjet Izraelit dhe Hamasit të nisura më 7 tetor, në mediat sociale u publikuan shumë përmbajtje të paverifikuara me pretendimin se paraqesin informacione rreth konfliktit. Pjesa dërmuese e këtyre përmbajtjeve janë publikuar në fushën e sigurisë, ndërsa një pjesë e vogël nga fusha e politikës dhe janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar dhe dezinformatë. Përmbajtjet keqinformuese nga kronika e zezë, që janë ndërlidhur me humbje jete, vrasje, fatkeqësi e tërmete të koduara si “raste tragjike” të publikuara nga portale informative në gjuhën shqipe janë radhitur si e dyta në trajtimin e temave me 6%.

Siguria dhe politika janë dy fusha që ndërlidhen me njëra tjetrën dhe së bashku përbëjnë më shumë se gjysmën e përmbajtjeve keqinformuese (73%), për muajin tetor. Shumica e përmbajtjeve nga fusha e sigurisë u vlerësuan si përmbajtje e paverifikuar dhe dezinformatë, të cilat u publikuan nga faqe në gjuhën shqipe në mediat sociale. Ndërkaq në fushën e politikës u publikuan dezinformata dhe lajme të rreme në mediat sociale në gjuhën shqipe dhe media reale në gjuhën serbe. Fushat tjera të keqinformimit përfshijnë socialen (9%) dhe kronika e zezë (9%).

Bazua në të dhënat monitorimit për muajin tetor 2023, publikimet keqinformuese në mediat sociale prijnë me 73%, duke u pasuar nga mediat reale me 23%. Gjatë këtij muaji, 96% e përmbajtjeve keqinformuese janë publikuar nga media dhe faqe në mediat sociale (Facebook) në gjuhën shqipe, ndërsa 4% në mediat në gjuhën serbe. Derisa gjysma e përmbajtjeve keqinformuese të publikuara në gjuhën shqipe janë nga fusha e sigurisë dhe politikës, të gjitha përmbajtjet në gjuhën serbe janë nga politikës, sigurisë dhe sportit. Publikuesit në gjuhën shqipe gjatë tetorit 2023, kanë publikuar më së shumti përmbajtje të paverifikuara me 29%, ndërsa dezinformatat zënë vendin e dytë 20%, pasuar nga lajmi i rremë me 17%. Ndërsa përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe janë vlerësuar si dezinformata (1%), dezinformata/përmbajtje e paverifikuara (1%) dhe teori konspirative (1%). Sa i përket publikimeve nga publikuesit në media sociale, 88% janë publikuar në Facebook, duke u pasuar nga TikTok me 12%.

Aleksandër Vuçiq dhe kryeministri, Edi Rama janë dy figurat më të përfolura në kontekst me personalitete tjera, në keqinformatat e publikuara nga publikuesit në gjuhën shqipe dhe serbe. Ndërkaq, sa i përket institucioneve, ato të sigurisë (FSK, Policia e Kosovës) u përfshinë dhe u përfolën në përmbajtjet keqinformuese, ku prinë Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK).

Kryeministri Albin Kurti, nuk e ka mbajtur premtimin e bërë në vitin 2021 gjatë një vizite në ndërmarrjen publike “Trepça” ku kishte premtuar investime 70 milionë euro në dy vite (2022 dhe 2023) për këtë institucion. Premtim i pa mbajtura nga Deputeti i Kuvendit të Kosovës, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Enver Dugolli, i ftuar në emisionin “Debat Plus” në televizionin Dukagjini ku ishte shprehur se çështja e mos-ekzekutimit të shtesave të rrezikshmërisë për Policinë e Kosovës do të zgjidhet për dy-tre ditë.

HIBRIDO.INFO